



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI " FAN S . NOLI "KORÇË**

**Adresa: Shëtitore "Rilindja" Tel/Fax: ++355 82 242230; ++355 82 242580
web: www.unkorce.edu.al e-mail: rektorati@unkorce.edu.al**

MIRATOHET:

REKTORI

Prof. as. dr. GJERGJI MERO

FAKULTETI I I BUJQËSISË

PROGRAMI I STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË

AGROBIZNES

VITI AKADEMIK 2014-2015

**PËRGJEGJËS DEPARTAMENTI
Prof. as. dr. NIKOLLAQ ROSHANJI**

**DEKAN
Prof. as. dr. IRENA KALLCO**

1. EMËRTIMI I PLOTË I PROGRAMIT TË STUDIMIT:

AGROBIZNES

2. OBJEKTIVAT FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MUNDËSITË QË AI I OFRON STUDENTIT PËR PUNËSIM

a) Profili kulturor dhe profesional i studentit në përfundim të programit.

Objekti kryesor i programit DNP ne Agrpbiznes synon tu jape studenteve njohurite e nevojshme dhe baze per formimin e tyre si specialist ne sektorin e agrobiznesit.

Kjo diplome ju ofron mundesi te gjithë atyre qe perfunndojne keto studime, shanse per tu njohur me menaxhimin e sipërmarjeve ne fushen e agrobiznesit. Ju meson si te merni persiper te organizoninje biznes te vogel, dhe te mesem privat nga pikëpamja e drejtimit financiar te agrobiznesit, ne lidhje me ekonomine globale per vendosjen e cmimeve , te drejtat dhe detyrimet e biznesit, ritjen e shkalles se konkurrimit te sa me shume firmave vendase. Kjo strukture ju ndihmon te punësoheni ne firmat rajonale dhe kombetare te agrobiznesit , ne bankat agrare etj.

b) Njohuritë dhe kopetencat që karakterizojnë profilin

Synimet kryesore të programit të studimit “Diplome e Nivelit të Parë” që do të merren në këtë kurs studimi janë :

- ❖ Të përgatisë specialistë të kualifikuar të aftë të përballen me sfidat e kohës për të drejtuar dhe organizuar ndermarje Agrobiznesi.
- ❖ Të përgatisë specialistë të aftë për të organizuar nje biznes se vogel dhe te mesem nga pikëpamja e drejtimit menaxheril.
- ❖ Të përgatisë specialistë konkurentë për pedagogë të rinj në institucione arsimore të mesme e të larta.
- ❖ Të përgatisë një brez punonjësish me vizione në të ardhmen për të garantur administrimin e ndermarjeve te vogla e te mesme me profil European.

c) Mundësitë për punësim

Një specialist i kësaj fushe mund të punësohet në të gjitha sektorët e bujqësisë, arsimit dhe shkencave bujqësore. Ai mund të punohet si :

- **Specialist Agrobiznesi,**
- **Pranë DBUMK (në sektorin këshillimor dhe atë të kërkimit),**
- **Në të gjitha OJQ që operojnë në fushën e Kredive Bankare**
- **Në shkollat e mesme profesionale te Agrobiznesit si mësues. Etj.**

3. STRUKTURAT AKADEMIKE PËRGJEGJËSE DHE STRUKTURAT E TJERA BASHKËPUNUESE

Fakulteti apo një strukturë tjetër mësimore e kërkimore	○ Fakulteti i Bujqësisë ○ Universiteti Bujqësor i Tiranës
Strukturat e tjera bashkëpunuese brenda institucionit apo në institucione të tjera të arsimit të lartë	○ DBUMK Korçë. ○ Qendra e Transformimi të Teknologjisë Bujësore Korçë. ○ Universiteti Bujqësor i Tiranës.
Subjekte të tjera publike apo private.	○ Mareveshje me dhomen e tregetise, bankat, Bizneset,

4. PËRSHKRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

- Kohëzgjatja e programit të studimit është tre vjet studimi, ku çdo vit akademik është i ndarë në dy semestra dhe secili semestër përmban 15 javë mësimore.
- Në studimet 3-vjeçare studenti zhvillon për lëndët e detyrueshme një numër orësh mësimore në auditor që ndryshon në varësi të lëndës nga 45-75 orë, ndërsa për lëndët me zgjedhje zhvillohen 39 orë mësimore në auditor.
- Studenti në një vit akademik, në këtë program studimi të ciklit të parë (3- vjeçar), zhvillon një numër të tillë orësh në auditor me qëllim plotësimin e 60 ECTS për ç'dovit akademik dhe në total për tre vite të plota studimi studenti merr 180 kredite me marrjen e diplomës.
- Ngarkesa minimale javore është 20 ore mësimi në auditor

5. PLANI MËSIMOR I PROGRAMIT TË STUDIMIT AGROBIZNES, CIKLI I PARË, VITI AKADEMIK 2014-2015

Viti I (parë)

Nr	Disiplina apo titulli i veprimtarisë	Tipi i veprim.	Kreditet	Leks.	Sem.	Lab.	Tot.	Simestri	Frekuentimi
1	Analize matematike	A	6	30	30	0	60	I	80%
2	Matematike ekonomike	A	6	30	30	0	60	II	80%
3	Prodhim bimor	A	5	30	15	15	60	I	80%
4	Prodhim shtazor	A	5	30	15	15	60	II	80%

5	Ekonomi Bujgesore	A	4	30	15	0	45	II	80%
6	Bazat e pentarise	C	4	30	15	0	45	II	80%
7	Bazat e perimtarise	C	4	45	15	0	60	II	80%
8	Statistike dhe vendimarrje ne biznes I	B	6	45	30	0	75	I	80%
9	Mikroekonomi	B	5	45	30	0	75	I	80%
10	Makroekonomi	B	5	30	15	0	45	II	80%
11	Informatike	E	5	30	15	0	45	I	80%
12	Gjuhë e huaj	E	5	0	60	0	60	I+II	80%
	GJITHSEJ (Viti i parë)		60	375	285	30	690		

Viti II (i dytë)

Nr	Disiplina apo titulli i veprimtarisë	Tip I verim.	Kreditet	Leks.	Sem.	Lab.	Tot.	Simestri	Frekuentimi
1	Statistike dhe vendimarrje ne biznes II	B	5	30	30	0	60	II	80%
2	Administrim Publik	B	5	30	30	0	60	II	80%
3	Bazat e marketingut	B	5	30	30	0	60	I	80%
4	Marketingu agrar	B	5	30	30	0	60	II	80%
5	E drejte biznesi	B	4	30	15	0	45	I	80%
6	Menaxhimi i burimeve njerezore	B	5	30	30	0	60	I	80%
7	Fitotekni	C	5	30	10	20	60	II	80%
8	Plehrat dhe Plehrimi	C	5	30	30	0	60	I	80%
9	Kontabilitet financiar	B	6	45	30	0	75	I	80%
10	Finance	B	5	45	30	0	75	II	80%

11	Paraja & Institucionet Financiare	B	5	45	15	0	60	I	80%
12	Cmimet dhe tregjet e Prod. Bujq	B	5	30	15	0	45	II	80%
	GJITHSEJ (Viti i dytë)		60	405	295	20	720		

Viti III (i tretë)

Nr	Disiplina apo titulli i veprimtarisë	Tipi i veprim.	Kreditet	Leks.	Sem.	Lab.	Tot.	Simestri	Frekuentimi
1	Drejtimit i Biznesit të vogël	B	5	26	26	0	52	I	80%
2	Politikat e menaxhimit të agrobiznesit	B	5	26	26	0	52	I	80%
3	Komunikim biznes	B	5	26	26	0	52	I	80%
4	Drejtimit Ferme	B	6	39	26	0	65	II	80%
5	Drejtimit agrobiznesi	B	5	39	13	0	52	I	80%
6	Etika e biznesit	B	3	26	13	0	39	I	80%
7	Analizë financiare	B	4	39	13	0	52	II	80%
8	Drejtimit financiar	B	6	39	26	0	65	II	80%
9	Financë Publike	B	3	26	13	0	39	II	80%
10	Lista A	D	6	52	26	0	78	I+II	80%
11	Lista B	D	6	52	26	0	78	I+II	80%
12	Mikroteza	F	6	0	0	0	67	II	80%
	GJITHSEJ		60	390	234	0	691		

6. FREKUENTIMI NË VEPRIMTARITË E NDRYSHME FORMUESE

- **Frekuentimi i veprimtarive mësimore. Frekuentimi** është i detyrueshëm. Detyrimet për frekuentimin e veprimtarive mësimore përcaktohen në:

- ✓ Leksione **80%**
- ✓ Seminare dhe ushtrime **80%**
- ✓ Laboratore **80%**

Në përfundim të studimeve të ciklit të parë studenti duhet të arrijë të fitojë **180** kredite.

7. FORMAT E STUDIMIT DHE TË VLERËSIMIT

Kërkesat dhe synimet e programit të studimit janë hartuar në përputhje me Ligjin Nr. 9741, datë 21.05.07 “Për Arsimin e Lartë dhe Shkencën në RSH”, i ndryshuar, dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit.

Përgatitja dhe zhvillimi i këtij programi studimi mbështet në udhëzimet e Ministrit të Arsimit nr. 4, datë 22. 01. 2008, nr.15, datë 04. 04. 2008, dhe udhëzimin e datës 22. 06. 2010.

- **Sistemi i studimit është me kohë të plotë**
- **Raporti vlerësim i vazhduar dhe vlerësim përfundimtar;**
- ✓ Vlerësimi i vazhduar 30%
- ✓ Vlerësimi përfundimtar 70%

Ky vlerësim është i paraqitur në syllabuset e secilës disipline.

- **Format e vlerësimit të vazhduar;**

Vlerësimi i vazhduar kryhet në disa forma si: **seminare, vlerësim me shkrim dhe me gojë, mbrojtje të punëve të kursit, detyrave, projekteve etj.** Ky vlerësim është i paraqitur në syllabuset e secilës disipline.

- **Forma e provimit përfundimtar të lëndëve apo moduleve; sezonet e provimeve/nr i krediteve për të kaluar nga një vit në tjetrin;**

Për çdo program studimi të ciklit të parë nuk mund të parashikohen në total më shumë se 22 lëndë. Vlerësimi përfundimtar (provimi) mund të bëhet për një disipline apo për një veprimtari formuese me module të koordinuara.

Për veprimtaritë formuese me dy a më shumë module bëhet vlerësim kolegjal i studentit. Secili modul ka kreditet e veta.

Për nxjerrjen e notës përfundimtare në këtë veprimtari formuese studenti duhet t’i fitojë të gjitha modulet që e përbëjnë atë.

Në qoftë se studenti kalon në modulën përkatës, ai i merr të gjitha kreditet e tij. Kreditet e grumbulluara nga studenti llogariten si shumë e krediteve të moduleve të marra nga ai. Nxjerrja e notës mesatare përfundimtare bëhet duke patur për bazë mesataren e ponderuar të notave të marra në modulet që e përbëjnë atë.

Në rast se nota mesatare përfundimtare nuk del numër i plotë, nota vihet në përputhje me tabelën e vlerësimit të studentit.

Në përfundim të procesit mësimor (në orët e fundit të mësimin), çdo pedagog që është përgjegjës lënde duhet t’u komunikojë studentëve në auditor:

1. Fitimin ose jo të së drejtës për t’u futur në provimin e disiplinës (modulit) përkatëse;

2. Rezultatit e vlerësimit të vazhdueshëm në seminare, laboratore, tema e detyra kursi apo në forma të tjera të kontrollit të ushtruar gjatë semestrit, si pjesë e vlerësimit përfundimtar.
3. Rezultati i vlerësimit të vazhdueshëm merret parasysh vetëm në vlerësimin përfundimtar të studentit, në sezonin e parë të provimeve.

- **Pasqyra e rezultateve të detyrimeve dhe provimit**

1. Vendimi i pedagogut (ose i pedagogëve të disiplinës) për futjen ose jo të studentit në provim, si dhe vlerësimi i tij (i tyre) për detyrimet, përshkruhet në Pasqyrën e Rezultateve të Detyrimeve dhe Provimit (kolona përkatëse).
2. Pasqyra e Rezultateve të Detyrimeve dhe Provimit përgatitet nga Sekretaria e fakultetit dhe nënshkruhet nga sekretarja përkatëse, përgjegjësi i departamentit përkatës dhe pedagogët që përbëjnë komisionin e provimit. Kjo pasqyrë mban vulën e Sekretarisë së Fakultetit.

- **Provimi**

1. Mënyrat e kontrollit të dijes (provim) përcaktohen në programin e disiplinës a modulit dhe pasyrohen në rregulloren mësimore të çdo programi studimi.
2. Provimi është formë e kontrollit të dijeve që duhet të përfundojë brenda afateve të parashikuara.

- **Llojet e provimeve**

1. Kontrolli i dijeve mund të bëhet: a) me shkrim, b) me gojë, c) i kombinuar (me shkrim e me gojë). Secili pedagog përcakton në sylabuset e disiplinës për kontrollin e dijeve nëse pjesa me shkrim e provimit mund të jetë përcaktuese apo eliminuese.
2. Tezat e provimit hartohen nga titullari i disiplinës dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit.
3. Gjatë zhvillimit të provimit (me shkrim ose me gojë) nuk lejohet ndërrimi i tezës.
4. Zgjedhja e formës së provimit bëhet nga pedagogu/ët i lëndës dhe pasqyrohen në rregulloren mësimore të programit të studimit qysh në fillim të semestrit, duke ua bërë të ditur studentëve.

- ✓ **Provimet me gojë**

1. Provimet me gojë duhet të zhvillohen në përputhje me veçoritë e disiplinës (modulit), sidomos për lëndë që kërkojnë shprehjen me gojë të studentëve, apo që janë lëndë thjesht teorike. Tezat e provimit me gojë duhet të përmbajnë pyetje të menduara mirë, që kërkojnë mendimin logjik të studentit, duke shmangur pyetjet që kërkojnë thjesht riprodhimin mekanik të njohurive. Një tezë për provimin me gojë duhet të përmbajë disa pyetje sintezë, që përfshijnë njohuritë kryesore që duhet të zotërojnë studentët në atë disiplinë a modul.
2. Problemet kryesore që përmbajnë tezat e provimit me gojë për disiplinën përkatëse duhet t'u jepen studentëve qysh më parë nga pedagogu. Këto probleme duhet të jenë në formën e standardeve që kërkojnë për përvetësimin e lëndës nga studentët.
3. Pedagogu ose pedagogët në provimin me gojë duhet të argumentojnë notën që i vihet studentit, duke patur parasysh përmbushjen nga ana e tij e detyrimeve në leksione dhe seminare, realizimin cilësor të detyrave të kursit, të kolokuiumeve etj., që janë pasqyruar në rezultatit e vlerësimit të vazhduar.

4. Numri i tezave për provimin me gojë varet nga vëllimi i disiplinës (modulit), nga sasia e leksioneve dhe e seminareve etj. Një kopje e tezave të provimit me gojë dorëzohet në departament një javë para zhvillimit të provimit, për t'u shqyrtuar dhe për t'u firmosur nga përgjegjësi i departamentit.
5. Studentët, në provimin me gojë, përgjigjet e tyre, sipas pyetjeve të tezës, i shkruajnë në fletoren tip të Universitetit "Fan S. Noli" dhe, pasi përgjigjen, ia dorëzojnë atë komisionit, duke shkruar emrin dhe mbiemrin përkatës.
6. Pedagogu i lëndës i mban këto fletore në departament deri në ditën e dorëzimit të Pasqyrës së Rezultateve në Sekretarinë e Fakultetit.

✓ **Provimet me shkrim**

1. Provimet me shkrim zhvillohen për disiplina a module me karakter teorik dhe praktik. Tezat e provimit me shkrim duhet të përmbajnë ushtrime të menduara mirë, që kërkojnë mendimin logjik të studentit, duke shmangur pyetjet që kërkojnë thjesht riprodhimin mekanik të njohurive. Pyetje të tilla përmbajnë ushtrime që kontrollojnë edhe përvetësimin e njohurive teorike nga studentët.
2. Numri i ushtrimeve që përmban një tezë e provimit me shkrim varet nga vëllimi i disiplinës (i modulit), numri i leksioneve dhe i seminareve etj. Një tezë e provimit me shkrim përmban ushtrime që vlerësohen me 100 pikë. Për çdo ushtrim vihen pikët përkatëse, në varësi të karakterit të ushtrimit.
3. Ushtrimet ose pyetjet që zgjidhen për tezën e provimit me shkrim duhet të përfshijnë në mënyrë tërësore disiplinën a modulën përkatës, të jenë të formuluar qartë, të mos lënë shteg për përgjigje dykuptimëshe, në mënyrë që vetë studenti të jetë të gjendje të bëjë vlerësimin për përgjigjet që ka shkruar.
4. Në qoftë se numri i studentëve dhe madhësia e auditorit nuk lejon që të përdoret vetëm një tezë me shkrim, komisioni mund të hartojë edhe një tezë tjetër (B), e cila duhet të plotësojë po ato kërkesa, sikurse teza A.
5. Komisioni, ditën e provimit, njofton studentët për datën dhe orën kur do të marrin përgjigjet.

• **Dokumentacioni i provimit**

1. Një kopje e tezave të provimit me gojë për çdo disiplinë ruhen në departament. Ato rinovohen herë pas herë, në varësi të ndryshimit të programit të disiplinës (modulit).
2. Procesverbalet e provimit me gojë dorëzohen në sekretari brenda 2 ditëve nga data e zhvillimit të provimit.
3. Procesverbalet e provimit me shkrim dorëzohen në sekretari brenda 6 ditëve nga data e zhvillimit të provimit.
4. Provimi zhvillohen në orën dhe datën e caktuar. Në rast pamundësie të zhvillimit të provimit ditën e caktuar, për arsye madhore, dekani, me urdhër me shkrim, njofton moszhvillimin e provimit dhe cakton një datë të mëvonshme, e cila u bëhet e njohur studentëve menjëherë.
5. Komisioni i provimit të një disipline përbëhet nga jo më pak se dy vetë, nga të cilët njeri duhet të jetë pedagogu i disiplinës.

6. Nëse titullari i disiplinës apo anëtari tjetër, për arsye madhore, nuk mund të marrin pjesë në provim, Përgjegjësi i Departamentit cakton me shkrim pedagogun që do t'i zëvendësojë.

- **Kohëzgjatja e provimeve**

1.Kohëzgjatja e një provimi me gojë është jo më shumë se 30 minuta për çdo student, ndërsa provimi me shkrim zgjat jo më pak se 2 orë.

2.Pas dhënies së tezës në provimin me shkrim, nuk lejohet futja në provim e studentëve të tjerë të grupit apo kursit përkatës.

3.Anëtarët e komisionit të provimit të disiplinës mbikqyrin zhvillimin korrekt të provimit gjatë gjithë kohës, nga dhënia e tezës deri në përfundimin e provimit.

4.Në raste flagrante, kur studenti kërkon t'i imponohet ose të kërcënojë me forma të ndryshme anëtarët e komisionit të provimit, këta të fundit duhet të ndërpresin provimin dhe të kërkojnë ndihmën e të gjitha instancave deri tek organet e ruajtjes së rendit publik për rivendosjen e kushteve normale të zhvillimit të provimit.

- **Studenti mbetës dhe ankimimi për provim**

1. Studenti ka të drejtë të ankohet në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose për vlerësim të pamërituar. Ankesa bëhet me shkrim *brenda ditës së marrjes së rezultatit për provimin me gojë dhe jo më vonë se 8 ditë për provimin me shkrim, nga data e dhënies së tij* dhe i drejtohet dekanit të fakultetit. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës brenda dy ditëve. Ky vendim është i formës së prerë.

2. Në rast se vërtetohen praktika që bien ndesh me dispozitat e kësaj rregulloreje, atëhere, me propozimin e Përgjegjësit të Departamentit, dekani vendos për ndryshimin e komisionit të provimit dhe për ridhënien e provimit/kolokuiumit brenda ditës ose të nesërmen, pas përfundimit të tij.

3. Studenti që për çfarëdo arsye nuk paraqitet në provimin e një discipline, humbet të drejtën e provimit dhe konsiderohet mbetës për atë disiplinë në atë sezon.

4. Gjithashtu studenti vlerësohet mbetës, kur:

a. Nuk është i përgatitur;

b. Tërhiqet nga provimi;

c. Kopjon ose mashtron me mjete ndihmëse jo të lejueshme (në këtë rast ai përjashtohet nga provimi).

d. Pengon zhvillimin e rregullt të provimit (në këtë rast ai përjashtohet nga provimi).

e. Studenti nuk lejohet të mbrojë diplomën, nëqoftëse nuk ka shlyer të gjitha detyrimet e vitit të fundit si dhe ato të mbartura.

- **Sistemi i vlerësimit**

1. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej dhjetë notash. Nota kaluese më e ulët është nota pesë.

2. Në format e kontrollit me shkrim përdoret edhe sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht kthehet në notë. Konvertimi i pikëve në notë bëhet sipas kësaj skeme: 40-55 pikë, nota 5; 56-65, nota 6; 66-75 pikë, nota 7; 76-85 pikë nota 8; 86-95 pikë, nota 9; dhe nga 96-100 pikë, nota 10.

3. Për vlerësimin përfundimtar të studentit mblidhen pikët e vlerësimit të vazhduar me vlerësimin në provim.

- **Njohja me rezultatet e provimit**

1. Pedagogu u bën me dije studentëve rezultatet e provimit në përfundim të provimit me gojë dhe, për provimin me shkrim, brenda 6 ditëve nga data e zhvillimit të tij.

2. Në rast se provimi zhvillohet në formën e pyetjeve me përgjigje alternative, komisioni shpall dhe çelësin e zgjidhjes.

3. Një kopje të pasqyrës së detyrimeve dhe provimit (origjinalin) e mban Sekretaria e Fakultetit dhe një kopje e mban sekretaria e departamentit.

4. Studentët, që nuk kanë mundur të informohen në kohë mbi rezultatet e provimit, informohen pranë sekretarisë së departamentit.

- **Riprovimet dhe mbartja e provimeve**

Studenti, i vlerësuar mbetës në dy sezonet e rregullta të provimeve (të dimrit dhe të verës), ka të drejtë:

1. Të përdorë të gjitha datat e shpallura nga fakultetet në sezonin e vjeshtës.

2. Për të kaluar në vitin e dytë (semestri i tretë), studenti që ndjek studimet në sistemin me kohë të plotë duhet të ketë përfituar minimumi 20 kredite dhe studenti që ndjek studimet në sistemin me kohë të pjesshme 15 kredite.

3. Për të kaluar në semestrin e pestë, studenti që ndjek studimet në sistemin me kohë të plotë duhet të ketë përfituar minimumi 60 kredite.

4. Ridhënia e provimeve për disiplinat(modulet) e pashlyera, lejohet gjatë vitit në vazhdim në sezonet e shpallura të provimeve (tri herë në vit) ose deri në vitin e fundit të studimeve.

5. Studenti i vitit të fundit, i cili në përfundim të provimeve të kursit, në sezonin e parë, rezulton me detyrime mësimore të pashlyera, ka të drejtë t'i shlyejë ato në sezonin e verës, para mbrojtjes së diplomës.

6. Studenti i vitit të fundit, i cili, në përfundim të provimeve të vitit të tretë, rezulton me detyrime mësimore, i shlyen ato në sezonin e vjeshtës dhe diplomën e mbron në këtë sezon.

DIPLOMIMI

1. Në përfundim të kursit të plotë të studimeve, studenti ka të drejtë të diplomohet për të fituar titullin përkatës profesional. Diplomimi bëhet me mbrojtjen e një teze diplome ose me provim formimi.

2. Departamentet përcaktojnë listën e tezave për diploma në fillim të semestrit të pestë. Ky përcaktim bëhet duke u mbështetur në fushat e studimit që mbulon departamenti.

3. Drejtuesit e tezave të diplomës miratohen nga përgjegjësi i departamentit.

4. Studenti merr përsipër shpenzimet për realizimin e temës së diplomës.

5. Diplomimi bëhet në sezonin e dimrit (mars), në sezonin e verës (korrik) dhe në sezonin e vjeshtës (shtator).

6. Studentit i lejohet të mbrojë tezën e diplomës vetëm mbasi të ketë shlyer provimet e prapambetura.

- **Forma e provimit të diplomës; kriteret e hartimit të pyetjeve për provimin e formimit;**

- Forma e provimit të diplomës kryhet me **tezën e diplomës** dhe **provimin e formimit**.
- Kriteret për të mbrojtur tezën e diplomës është kur studenti ka një mesatare mbi 7 për dy vitet e para të studimit.
- Nga disiplinat kryesore hartohen pyetjet që u jepen studentëve 2 muaj para sezonit të provimit.

- **Kriteret e përzgjedhjes së studentëve dhe të hartimit të punimit për mbrojtjen e diplomës:**

Teza e diplomës të nivelit të parë është një punim, në formën e një projekti apo përmbledhjeje punimesh të kryera në fushat e programit përkatës të studimit.

Teza e diplomës përmban kërkesa, mënyra e shtrimit të të cilave i jep mundësi studentit, që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit, të tregojë aftësitë e tij për të zgjidhur elementë të veçantë të detyrave, në fushën përkatëse.

Teza e diplomës është e lidhur me disiplina të përafërta dhe duhet të jetë individuale. Studenti që plotëson kriteret e përcaktuara nga kjo rregullore ka të drejtë të shprehë dëshirën e tij në lidhje me tezën e diplomës që kërkon të zhvillojë, dhe udhëheqësin e tij.

Departamenti shqyrton të gjitha kërkesat specifike të studentëve, duke i harmonizuar ato me kushtet aktuale

STRUKTURA E PUNIMIT

Punimi duhet të shkruhet me shkrim Times Neë Roman, Font 12, Hapësira midis rreshtave 1,15.

1. HYRJE: PËRSE KJO TEMË? (2 faqe)

2. ÇËSHTJET THEMELORE NË FUSHËN E BRENDISË (3 faqe)

4. ARGUMENTET DHE ANALIZA E TË DHËNAVE (20 faqe)

5. PËRFUNDIME, PROPOZIME, BIBLIOGRAFI (5 faqe)

8. INFRASTRUKTURA NË DISPOZICION TË PROGRAMIT

Sallat e leksioneve dhe të seminareve (kapaciteti): Programi I studimit ka ne dispozicion 3 auditore me kapacitet 120 vende per zhvillimin e leksioneve

Laboratorët: Programi I studimit ka ne dispozicion 7 laboratore

Biblioteka: Programi I studimit ka ne dispozicion I biblioteke te fakultetit te bujqesise

Sekretaria Mësimore: Programi I studimit ka ne dispozicion nje sekretari mesimore te fakultetit te bujqesise

Departamenti: Programi I studimit Agrobiznes ben pjese ne departamentin Hortikulture Agrobiznes